



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

BASHKIA BERAT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ prot.

Berat, më ____ .09.2026

Procesverbal - Tipi i kontrates - Mall

(Për argumentimin dhe miratimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROÇEDURËS: “BLERJE MATERIALE DEKORI”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT: Kodi CPV: 31500000-1, shirita- zbukurime, 45451000-3 “Dekorime”, Kabllo të tensionit të ulët 31321210-7,

VLERA E FONDIT LIMIT: 6.241.500 (*gjashtë milion e dyqind e dyzet e një mijë e pesëqind*), lek pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Shërbimeve Publike ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve të kualifikimit për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 8.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2.1. Ofertuesit duhet të paraqesin:

Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **shtojcës 9**
Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4**

***Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve ekonomike, teknike dhe profesionale, Njësia e Prokurimit bazuar në natyrën dhe përmasat e kontratës, specifikimet teknike dhe grafikun e lëvrimit të mallit, gjykon që pjesë e kriterëve të vecanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e mëposhtme, me qëllimin kryesor që t’i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të njohur gjendjen dhe kapacitetet e nevojshme të Operatorëve Ekonomikë ofertes, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Konkretisht Njësia gjykon vendosjen e kriterëve si vijon:

2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar Ofertuesit duhet të paraqesin:

2.2.1 Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar në kontratë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi:Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe në pikën 1, 2 dhe 3, të nenit 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në objektin e kontratës, natyrën dhe volumnin e saj. Vlera e marzhit të xhiros së kërkuar në kufirin e përcaktuar më sipër, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapaciteteve ekonomike dhe financiare të Operatorëve Ekonomikë ofertes, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter është në përputhje edhe me legjislacionin e fushës, konkretisht, Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Për Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte bere ne mbeshtetje VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku percaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

2.2.2. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të tre viteve të fundit të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore , të konfirmuara nga ky autoritet që te tregojne raportet midis aktivitetit dhe pasivitetit
Shenim: Ne respektim te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43, pika 4, kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur nqs dy bilancet e njepasnjeshme nuk kane raport negativ ndermjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Raporti pozitiv ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit të bilanceve të dy viteve të njepasnjeshme, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapaciteteve ekonomike dhe financiare të Operatorëve Ekonomikë ofertues, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter është në përputhje edhe me legjislacionin e fushës, konkretisht, me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe në kërkesat e Ligjit Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29, të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaraten vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që

prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik**, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

dhe/ ose

- b) **Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat**, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe në pikën 4, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, (**në rastin e procedurave të hapura thjeshtuara neni 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar**).

Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit.

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumnin e saj dhe shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor për të njohur gjendjen dhe kapacitetet e Operatorëve Ekonomikë ofertues, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme është një element i rëndësishëm që garanton Autoritetin Kontraktor, se Operatorët Ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitetet e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Kjo kërkesë është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit dhe njëkohësisht është brenda periudhës dhe vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. ISO 9001:2015 - Çertifikim për menaxhimin e cilësisë ose ekuivalente (e vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të kontratës) në përputhje me objektin e prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qenë se kjo lloj çertifikate ISO mund të ketë evoluar ndër vite do të pranohet edhe çdo lloj standardi tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kësaj ISO;

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ku parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit si dhe gjithashtu në mbështetje të nenit 40, pika 7/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit”.

Menaxhimi i cilësisë i çertifikuar përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme të biznesit si dhe provën e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave të klientit.

ISO 9001 përfaqëson standartin ndërkombëtar unanim i njohur si standarti që i perket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilësisë. Ky standart aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës së aktivitetit.

Ky kriter kërkohet që OE është i certifikuar sipas standartit ndërkombëtar që produktet apo pajisjet e sjella janë të garantuara në cilësi dhe nuk janë produkte të pakontrolluara apo të falsifikuara.

2.3.3 Operatori/ët Ekonomik duhet të paraqes/in deklaratë që furnizimi i mallrave do realizohet me mjetet dhe shpenzimet e operatorit ekonomik fitues brenda afatit të përcaktuar nga Agjencia e Shërbimeve Publike Bashkia Berat.

Argumentimi Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një **mostër, (kampion)**, për çdo zë të mallrave objekt prokurimi ditën e hapjes së ofertave në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit (pranë magazinës së Agjencisë së Shërbimeve Publike, Rr. Baki Gjebrea, Rajoni Nr. 1),

Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues.

Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara. Mosparaqitja e mostrave ditën e hapjes së ofertave përbën kusht për s’kualifikim.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në mbështetje të germës a pika 6 e nenit 40 të VKM- së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit: “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. **Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentoj kërkesën për mostrat.** Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

Njësia e prokurimit në përcaktimin e këtij kriteri mbështetet në faktin se për të verifikuar përputhshmërinë e materialeve elektrike me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit është e domosdoshme paraqitja e mostrave, për zërat e kërkuara si më sipër.

Mostrat janë kërkuar vetëm për një pjesë të materialeve të cilat konsiderohen të nevojshme për tu verifikuar në lidhje me cilësinë e tyre dhe a janë sipas standardit që janë kërkuar.

Për këtë arsye, referuar llojit dhe funksionit që ato kanë, kërkesa për paraqitjen e këtyre mostrave, vlerësohet e nevojshme dhe e mjaftueshme për realizimin e synimit të Autoritetit Kontraktor duke mos rënduar pozitën ekonomike të operatorëve ekonomik pjesëmarrës.

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performancë, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë përshkruar saktë dhe në mënyrë të plotë duke qenë të paanshme, lidhur me kërkesat e Autoritetit Kontraktor për furnizimin me materialet elektrike, duke u mbështetur në standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke pasur parasysh garancitë përkatëse të këtyre sistemeve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në përcaktimin e specifikimeve teknike për materialet elektrike janë vendosur parametra teknikë sipas nevojave funksionale të Bashkisë Berat dhe Njësive Administrative duke përdorur një minimum dhe maksimum të parametrave me qëllim për të mos kufizuar konkurrencën si dhe për të patur një pjesëmarrje të lartë të operatorëve ekonomikë.

Specifikimet teknike nuk kanë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emri të veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ka ekzistuar një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, dhe është cituar fjala “ose ekuivalent” e përfshirë detyrimisht në këto specifikime.

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Shirit Led Fleksibël për ambjent të jashtëm (i gomuar, Neon, i bardhë) 220 v, 6500 kelvin	pako	100
2	Shirit Led fleksibël për ambjent të jashtëm (i gomuar,i ngrohte Neon) 220 v, 3000 kelvin	pako	500
3	Konektor ushqyes per shirit led 220 V	pako	500
4	Drita dekori të ngrohta me pika të bardha, 10 metroshe	pako	50
5	Drita dekori të ngrohta me pika të bardha, 20 metroshe	pako	50
6	Drita dekori të kuqe me pika te bardha, 10 metroshe	ml	1,500
7	Drita dekori të bardha, me pika të bardha, 10 metroshe	ml	300
8	Drita dekori të bardha, me pika të bardha, 20 metroshe	cope	50
9	Shirit dekorues jeshil , gjatesi 2.7 m	ml	1,000
10	Varg me portollampa me izolim PVC , 50 cm	cope	1,000
11	Llamba led dekorative 4 w	pako	50
12	Nastro 3M	pako	50
13	Fasheta plastike 30 cm	pako	50
14	Fasheta plastike 15 cm	ml	1,000
15	Fasheta plastike 10 cm	cope	500

16	Zbukurime për pemën, globe shumëngjyrëshe me permasa fi 10	cope	200
17	Zbukurime për pemën, elementë të ndryshme dekorative, fjongo dekoruese, flokë bore dekorative,kambana dekorative.	cope	100
18	Profile 20*20 , (6 m)	ml	360
19	Hekur fi 8 periodik	ml	300
20	Hekur fi 8 joperiodik	ml	500
21	Hekur fi 10 joperiodik	ml	500

NJËSIA E PROKURIMIT

Roland Deda

Brikena Halitaj

Anxhelo Doga

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Joana Melengu